



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



GRUPI SHQIPTAR I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Nr. 274 Prot, datë 12.04.2013

Nr. 521 Prot, datë 10/04/2013

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

GRUPIT SHQIPTAR TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Kjo marrëveshje ka për qëllim, institucionalizimin e bashkëpunimit të institucionit të GSHDNJ dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e punës për realizimit të veprimtarive që synojnë zhvillimin e politikave, aktiviteteve trajnuese dhe ligjeve në favor të të drejtave të njeriut, luftës për eliminimin e diskriminimit për shkak të moshës, statusit, gjinisë, fesë, si dhe për avancimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri, barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, për përmirësimin e të drejtave të komuniteteve të marginalizuara, veçanësisht komunitetit LGBT në Shqipëri.

Kjo marrëveshje, konkludon si më poshtë vijon:

1. **GSHDNJ** është një organizatë e themeluar në 1996 që punon në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke synuar promovimin e këtyre të drejtave, zbulimin dhe investigimin e tyre, zgjidhjen nepermjet rrugëve ligjore të rasteve përmes ofrimit të konsulences, trajnimeve dhe perfaqësimit ligjor me avokat në Gjykatat e Shqipërisë dhe në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.
2. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjitha mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të ratifikuar nga RSH për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

3. **GSHDNJ** synon që gjatë periudhës 1 vjeçare të implementojë projektin për trajnimin e gjyqtarëve në pesë rrethe të RSH lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në RSH. **GSHDNJ** do bashkëpunojë me **Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi Znj. Irma Baraku** që të sigurojë edhe praninë e Zyrës së Komisionerit në çdo aktivitet trajnimi që do të aplikohet në zbatim të këtij projekti me gjykatësit e rretheve gjyqësore përkatëse (Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Berat).

4. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë deri në përfundim të projektit.



IRMA BARAKU

KOMISIONERE PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

ELSA BALLAURI

DREJTORE EKZEKUTIVE E GSHDNJ

